



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2237 Prot.

Tiranë, më 26.09 . 2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 111 dt. 26.09 . 2025

“PËR

**SHTYRJEN E AFATIT TË THIRRJES PËR VETËKANDIDIM PËR ANËTAR TË
 KOMISIONIT TË KËRKIMIT, PROJEKTEVE DHE BOTIMEVE SHKENCORE”**

Në zbatim të nenit 38 pika 1 (gërma i) të nenit 38, nenit 46 pika 3 dhe 6 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 20 (gërma nj) si dhe nenit 26 të Statutit të UST-së, nenit 4 të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Përhershëm, në Nivel Institucioni, të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore, nenit 17/1, nenit 23 të Rregullores për Organizmin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST dhe njoftimin e Sekretares së Senatit Akademik me nr. 2236 Prot, datë 26.09.2025 për shtyrjen e afatit të thirrjes për vetëkandidim, Senati Akademik

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të thirrjes për vetëkandidim për anëtar të Komisionit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore, me këtë përbërje:
 - 5 (pesë) anëtarë nga personeli akademik i UST-së, që i përkasin kategorisë “Profesor”;
 - 1 (një) anëtar përfaqësues i stafit administrativ;
 - 1 anëtar përfaqësues i studentëve;
2. Regjistrimi i kandidatëve të kryhet pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UST-së nga data 26.09.2025 deri në 01.10.2025
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA



Rr. Muhamet Gjollësja, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

Prof. Dr. Arben KAÇURRI

Prof. Dr. Dhurata BOZO

Prof. Dr. Ferdinand MARA

Prof. Asc. Klotilda VRENJO

Prof. Asc. Oltiana PETRI

Prof. Dr. Robert ÇINA

Dr. Aisel OSEKU

Prof. Asc. Elton SPAHIU

Prof. Asc. Fisnik BROVINA

Prof. Dr. Kujtim KAPEDANI

Prof. Asc. Robert ÇITOZI